

University of Business and Technology in Kosovo
UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 2-2019

TAKSAT

Arbnora Hetemi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>

 Part of the [Business Commons](#)



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

TAKSAT

Shkalla Bachelor

Arbnora Hetemi

Shkurt, 2019

Prishtinë



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti Akademik 2013 -2014

Arbnora Hetemi

TAKSAT

Mentori : Prof. Dr. Bukurie Jusufi

Shkurt, 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKTI

Konceptualizimi apo shtrirja në hapsirë dhe kohë i rregullimit ekonomik të nje vendi përmesë të hyrave qe akumulon ka qenë dhe mbetet sfida me e madhe e demokracisë moderne. Baza e mbledhjes se të hyrave nga nje vend nuk është proces që ka lindur me shtetin modern andaj mbjedhja e tyre është po aq e vjetër sa vetë ekzistenca e shoqerive te para. Andaj leht mund të themi se menagjimi i parasë publike daton shumë herët ne rregullimet e para shoqerore.

Punimi ne fjalë është shtrirje mbi po ketë efekt të të hyrave publike ne rregulimin shoqeror te një vendi. Këto të hyra janë të shprehura kryesisht ne dy forma kryesore :Taksa dhe Tatime. Qellimi kryesor i punimit është që të fokusohet ne motorin kryesor të akomulimit të të hyrave, ne ketë rast Taksave, si dhe diferencimit të tyre ne raport me Tatimet si metodë e dytë e mbledhjes se të hyrave.

Fillimisht punimi në fjalë shtjellon konceptin dhe rëndesinë e financave publike dhe shpenzimeve publike duke e konsideruara si pararendës të shtjellimit të taksavë si njëra nga nga metodat e zhvillimit të politikave fiskale në një shtet. Shtuar kësaj punimi shtjellon tiparet kryesore të Taksave, qëllimet e tyre si dhe metodat që qojnë në akumulim te tyre ne shoqeritë moderne. Të hyrat ne ketë punim janë shfrytzuar përmes mbledhjes se të dhënave tekstuale nga burimet e studimeve te publikuara. Është e rëndësishme të thuhet se studimi mbi rëndësinë dhe konceptin e Taskave si instrument ka për qellim të thjeshtësojë gjithë ketë motor te funksionimit te parasë publike ne rezultate te prekëshme që të shihet vitaliteti dhe patjetërsimi i rendësisë se te hyrave publike përmes taksave . Shtuar kesaj nje përmbledhje do të ketë edhe sistemi i taksimit ne Kosovë si shoqeri e re dhe rendesinë e tyre ne zhvillimin e vendit .Ne fund tëndenca është qe të kemi ni fotografi te qartë se ç´farë formule është koncepti i te hyrave publike përmes taksimit dhe të shihet se ç´farë barriere mund të ketë nje shoqeri moderne pa sistem efikas të mbledhjes se kësaj forme te të hyrave dhe si shfaqet kjo krahas rregullimit ekonomik qe ka.

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Fillimisht dua të shprehë një falenderim te veçantë për Kolegjin Univerzitarë UBT, Rektorin dhe gjithë stafin menaxherial për punën kualitative dhe te palodhëshme në ngritjen e një institucioni prestigjioz, përfitues të secilit jemi te gjithë ne studentet.

Një falenderim i veçantë i'u shkon mësimit dhe gjithë pjesës tjetër të stafit akademik për punën e jashtzakonshme që kanë bërë gjatë kësaj periudhe të studimeve të mia dhe për ngritjen tonë profesionale. Puna e tyre ishte e palodhëshme dhe e vazhdueshme për përmirësimin tonë të vazhdueshëm dhe përgaditjen për sfida të tjera që do të përballemi.

Falenderojë profesoreshën Bukuriye Jusufi , si mësimit dhe ashtu edhe si mentore gjatë punimit të kësaj Teze të Diplomës. Puna e saj duke qëndruar pranë përmes një monitorimi të vazhdueshëm dhe lehtësim të punës dhe përmes thjeshtësimit e përmirësimin deri të një përpunim sa më profesional të temës ishte mesë domethënëse.

Një falënderim i'u shkon kolegëve, familjës dhe shoqërisë për mbështetjen e vazhdueshme dhe kohën që ndanë gjatë studimeve të mia që të mbyllet si një kapitull i suksesshem në karrierën time profesionale.

Faleminderit të gjithëve !

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE.....	5
LISTA E SHKURTESAVE	5
1. HYRJE	1
2. SHYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1. Funksionet bazike të Financave Publike në përgjithësi	3
2.2. Shpenzimet Publike dhe raporti i tyre me të Hyrat Publike (Taksat dhe Tatimet).....	4
2.3. Karakteristikat dhe Koncepti i Taksave.....	6
2.4. Principet e taksave	7
2.4.1. Përparësija historike	7
2.4.2. Paanësija	8
2.4.3. Efikasiteti	8
2.4.4. Neutriliteti	8
2.4.5. Parashikimi dhe Siguriya	8
2.4.6. Proporcionaliteti dhe progresiviteti.....	8
2.4.7. Thjeshtësija	9
2.5. Lartësia e taksave.....	9
2.6. Arkëtimi i taksave	10
2.7. Klasifikimi i taksave	12
2.8. Dallimet mes taksave dhe tatimeve	15
2.9. Sistemi i Taksave në BE	16
2.9.1. TVSH dhe Akciza	16
2.9.2. Taksa në ndërmarrje dhe taksa në të hyra	17
2.9.3. Të ardhurat e Taksave	17
2.9.4. Taksa në një treg të përbashkët	17
2.9.5. Standartizimi i taksave në të mira dhe shërbime	18
2.9.6. Evazioni i taksave dhe shmangia e tyre	18
2.9.7. Taksa e transaksionëve financiare	19
2.10. Strategjia e politikave të taksimit në BE	19

2.10.1.	Parimet bazë.....	19
2.10.2.	Largimi i pengesave për qytetarët	19
2.10.3.	Veprime të tjera në në politiken e takasve.....	20
2.11.	Taksat dhe Tatimet në Kosovë.....	20
2.11.1.	Korniza ligjore e organizimit te politikës fiskale në Kosovë	20
2.11.2.	Funksioni dhe roli i ATK si agjension përgjegjës për alokimin e të hyrave 22	
3.	DEKLARIMI I PROBLEMIT	25
4.	METODOLOGJIA	26
5.	PREZANTIMI DHE ANALIZIMI I REZULTATEVE	28
6.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	30
7.	REFERENCAT	32

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Llojet e tatimeve në Kosovë 24

LISTA E SHKURTESAVE

UBT- Kolegji Univerzitarë për Biznes dhe Teknologji

BE - Bashkimi Evropian

GDP (BVP)- Gross Domestic Product (Bruto Produkti Vendorë)

OECD - Organisation for Economic Co-operation and Development (Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim)

TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

INDEP - Institute for Development Policy (Instituti për Politika Zhvillimore)

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës UNMIK- United Nations Mission in Kosovo (Misioni i Kombëve të Bashkuara në Kosovë)

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

USAID - The United States Agency for International Development (Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar i Shtetëve të Bashkuara)

1. HYRJE

Shekulli ne të cillin jetojmë dhe veprojmë si shoqëri e avansuar ne ç' do fushë të jetës duke filluar nga koncepti ekonomik, politik, juridik dhe ai i mirqënjes është një mozaik i bashkëveprimit i bazuar në një grumbuj rregullash dhe ligjesh të cilat i japin kuptim asaj që njihet si sistem i jetesës. Në këtë mozaik padyshim që shtyesi më i madh i një stabiliteti të mirqënjes është stabiliteti ekonomik, në thelb ekzistenca e të hyrave sistematike është motori kryesor shtyës në këtë proces. Sektori publik përkatësisht i të hyrat publike dhe menaxhimi i tyre përbejnë pothuajse një të tretën e ekonomisë kombëtare . Mbledhja dhe shpërndarja e të hyrave apo financat publike janë metodë e menaxhimit të të hyrave nga institucionet shtetërore dhe kjo daton qysh heret tek sistemet e vjetra Greke, Romake dhe Egjiptiane (në shumicën e rasteve në të kaluarën ishin selektive dhe larg me ato që sot njihen si taksim proporcional).

Ajo që sot luan rol njëra ndër metodat kryesore të financimit publik e që janë taksat është se janë të nderlidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik-politik të shtetit dhe mirqënjen e qytetarit. Sistemi i taksimit sot kryhet në dy nivele të ndryshme, ndaj personave fizik dhe atyre juridik (të gjitha etnitetet e tjera ligjore) e cila shëndrrohet në një formë retroaktive të investimit të shtetit në shërbime publike dhe investime kapitale për përmirsimin e jetës së qytetarit.

Si koncept i tillë i vetë ekzistencës së shtetit sidomos mirqënjes dhe stabilitetit ekonomik, sistemi i taksave bënë që të jetë arritja më e madhe e organizimit ekonomik brenda shtetit modern, andaj edhe studimi në këtë punim do jetë i shtrirë në nivele të ndryshme duke filluar nga karakteristikat kryesore të taksave dhe principet e tyre, nivelizimin apo lartësinë e taksave të ndara, mbledhjen e tyre dhe menyrat se si taksat ndikojnë drejtpërdrejt në mirqënjen ekonomike. Ky studim për qëllim nuk ka vetëm qasjen teorike ndaj konceptit taksë por edhe shtrirjen praktike të saj siq janë karakteristikat e bazë të këtij sistemi të organizimit ekonomik në vendet si BE e SHBA për të nxjerrë një përfundim sa më të përafert me formulimin sa më adekuat të sistemit të taksimit edhe në shtetin e Kosovës.

Në perfudim pretendojmë qe të arrimë në një rrumbullaksim te asaj, se si sistemi i taksimit ne thelb është baza kryesore e ekzistencës ekonomike dhe se efikasiteti ne akumulim dhe menaxhim te mirefilltë te tyre është esencial sidomos për vendet ne zhvillim siq është Kosova.

2. SHYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Funkcionet bazike të Financave Publike në përgjithësi

Fillimisht le të kthehemi pak pas dhe ti qasemi funksionëve bazë që kanë financat publike. Në bazë të një ndarje që profesor Sabahudin Komoni në librin e tij Financat kemi tri funksione bazë të që kryejne financat publike :

a) Funkzioni alokativ i financave publike

Ky funksion e ka për detyrë t'i drejtojë apo edhe t'i shperndajë mjetët të cilat mbledhe ne shoqëri gjithmonë më qëllim plotsimit të nevojave publike dhe në pjesën tjetër që siguron mjetët për ofertën e të mirave në treg. Në bazë të kësaj edhe në kuadër të vetë sektorit publik bëhet mbledhja e të hyrave apo alokimi i mjetëve.

Ky funksion nuk ka të bejë vetëm më mbledhjen e të hyrave por gjithashtu edhe më vetë ndikimin e sektorit publik përmesë të hyrave dhe shpenzimeve publike në ecurinë e funksionimit të subjekteve ekonomike në sektorin privat dhe në gjithë ekonominë e vendit.

b) Funkzioni i rishpërndarjes (ridistribuimit)

Ky funksion ka të bejë më rishpërndarjen e mejtëve apo të ardhurave ndërmjet individit dhe shtetit në mes sektorëve dhe regjioneve . Edhe pse mund të themi që kjo do duhej të krijonte një balancë të drejt ne mesë të politikave fiskale që realizon shteti dhe stabilitetit financiar duke konsideruar së rishpërndarja e tyre ndodhë përmes tregut, prapëseprapë kërkesat sociale dhe politike në shtetë mbesin ende të paplotsuara.

Andaj më masat e politikave fiskale duhët që të arrihet një suazë optimale e raportit të shpërndarjës së të ardhurave.

c) Funkzioni stabilizues

Ky funksion padyshim është në rolin e stabilizatorit të gjendjës ekonomike në nje vend të caktuar. Financat publike këtu luajn rolin stabilizues atëherë kur ekonomia nacionale e një

vendi del nga ekuilibri dhe është e nevojshme intervenimi i shtetit me masat e politikës ekonomike dhe në këtë drejtimedhe me masat në politikën e të hyrave dhe shpenzimeve publike.

Përmesë kësaj tëntohët që të vëndosët serish ekuilibri që përfshinë stabilitetin në treg të qmimeve , inkuadrimi i plotë i resurseve njëzore dhe materiale, ekuilibër në Bilancin e pagesave , shkalla e caktuar e ngritjës ekonomike dhe ndryshimet strukturale.

Gjithmonë duhet të kemi parasysh së financat publike janë të lidhura më shtetin dhe rolin aktiv të tij në tregun e lirë, edhe pse ekzitojnë mendime të ndryshme në specikimin e rolit të shtetit në ekonomi (Komoni, 2008, fq.13 -15).

2.2. Shpenzimet Publike dhe raporti i tyre me të Hyrat Publike (Taksat dhe Tatimet)

Shpënzimet Publike nga esenca e të kuptuarit si pjesë e studimit të financave publike kanë dy cilësi bazë :

- Shpenzimet publike shërbjenë për plotsimin e nevojave kolektive dhe interesave publike si dhe
- shpenzimet publike bëhen në para.

Shpënzimet ne formë të tillë padyshim që ofrohën në një proces më qëllim të njejtë ashtu siq kanë edhe të hyrat publike (taksat dhe tatimet). Gjithashtu duhetë thenë së burmi i këtyre shpenzimeve vjenë drejtpërdrejtë nga po të hyrat publike të alokuara në një proces të mëhershëm. Këto shpenzime i bënë shteti apo qfardo subjekt juridiko-publikë në mënyrë të përfitimit publik dhe në shërbim të qytetarëve të vendit. Shpeshherë në literaturat që merren më këtë sferë të studimit mund ta gjejmë edhe termin shpenzime shtetërore më qëllim që të shihet roli i drejtpërdrejtë i shtetit në këtë proces.

Ekzistojnë nëvoja të caktuara të cilat shpenzimet publike kryejnë duke filluar nga :

- Nevojat e përgjithëshme shtetërore (administrata publike, organët përfaqësuese , subvencionët , etj.)
- Nevojat e përbashkta apo kolektive (arsimi, kultura, shkenca, sigurimet sociale e shëndetësore, etj)
- Nevojat e natyrës ekonomike të shtetit (intervenimi i shtetit në ekonomi dhe në mardhënjët ndërkombëtare ekonomike të shtetit , investimet infrastrukturore, etj.)

Në përgjithësi ekzistojnë disa struktura të shpenzimeve publike siq janë :

- **Shpenzimet administrative shtetërore** të cilat përfshinë shpenzimet personale dhe materiale për financimin e veprimtarisë dhe funksionin e aparatit administrativë shtetërorë .
- **Shpenzimet ushtarake** për mbrojtjen e vendit e të cilat varen shumë prj mardhenieve dhe ecurive ndërkombëtare. Me pasë këto shpenzime kanë një efekt në zhvillimin e vendit , angazhimin e kapaciteteve të prodhimit, uljen e papunësisë ,etj.
- **Shpenzimet e mbrojtjes dhe sigurisë së brendshme**, që përfshinë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytëtareve , mbrojtjen e pasurisë së tyre, mbrojtjen e sistemit politik , juridik e ekonomik si dhe të gjitha organeve te gjyqësisë, prokurorisë, dhe juridikaturës të cilat janë në funksion të mbrojtjes dhe sigurisë së brendshme.
- **Shpenzimet Publike të sigurisë sociale të popullsisë** i cili përfshinë një sigurim taksativ socialë të obligueshëm dhe vullnetarë e që përfshinë : a) Sigurimin pensional-invalidorë b) sigurimi ne rastë të papunësisë si dhe sigurimet e tjera që përfshinë ata që nuk janë në gjëndje ta sigurojnë ekzistencën jetësore (të varfërit, të paafitit për punë, të moshuarit e semurë, familjet me shumë femijë, etj.) por këtu përfshihen edhe sanimet e pasojave të fatkëqsive elementare, ndërtime e banesave për kategoritë e varfra , etj.
- **Shpenzimet e arsimit** janë të vëllim të madh dhe të rëndësishëm e që varen prej nivelit të arsimimit të popullësisë , kanë ndikim shumë të madh të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik e social.

- **Shpenzimet publike në rast të fatkeqësive elementare** ku përfshihen çrregullimet politike (p.sh. lufta) dhe trazirat sociale. Këto shpenzime për sanimin dhe stabilizimin e situatave të tilla. Këtu përfshihen edhe shpenzimet që bëhen në mbrojtjen e ajrit, ujit, dhe tokës si dhe shpenzimet në zvoglim të zhurmës dhe rrezatimit. Krejtë këto në rritje e cilësisë së produkteve të lartëpërmendura .

- **Shpenzimet e shtetit në intervenimin ekonomik** përfshinë investimet ne infrastrukturë dhe bëhet në dy menyra kryesorë, përmes intervenimit të drejtëpërdrejtë dhe indirekt. Këtu shteti ndikon në orientim te investimeve dhë strukturën e tyre , në zhvillim të ndonjë dege të ekonomisë apo edhe regjionit, si dhe ndikonë në stabilizim të ekonomisë në rast krizash(Komoni, 2008, fq.19 -22).

2.3. Karakteristikat dhe Koncepti i Taksave

Nuk mund të themi se ekziston nje koncept i pergjithshëm i definimit te taksave por pergjithsisht taksat njihen si te hyra monetare te cilat shfrytzohen per financime publike, ku si obligues ne kryerjen e kesaj detyre janë personat fizik dhe juridik. Si formë e rikthimit te ketyre te hyrave janë sherbimet që ju kthehen qytetarëve nga vendi apo pushteti mbledhës i tyre. Nje shembull i tillë mund te mirret rasti kur qytetarët kryejn detyrimet e tyre ne pagesa,siq janë te hyrat nga pagesat per dokumenta zyrtarë apo edhe kerkasat e tjera te cilat ju drejtohen institucioneve publike per kryerjen e shërbimeve e te cilat me mbledhjen apo alokimin e buxhetit rikthehen ne formen e investimeve ne vitet ne vijim.

Taksat kanë dy karakteristika kryesore :

Karakteristika e parë është se taksat paraqesin kundërsheperblimin për sherbimin e kryer nga ana e organeve shtetore.

Karkteristika e dytë është se obliguesit me iniciativen e vetë nxisin organet kompetente qe kryejn shërbime , dhe ata janë te obliguar qe të paguajnë per to (Komoni, 2008).

Keto dy cilësi i bëjnë taksat drejtpërdrejtë të dallueshme prej tatimeve dhe formave tjera te mbledhjes financiare. Taksat janë obligim i cili drejperdrejt percaktohet nga institucioni

pergjegjës shtetrorë , ashtu qe lartësija e tyre dhe menyra e alokimit është bazë e nje sistemi ligjorë te paracaktuar e cila asesi nuk bjen ndeshë me bazën e kushtetuesmerisë se vendit perkatës. Mos alokimi i ketyre mjetëve detyron organët pergjegjëse shtetrorë të bejnë arketim detyruës te dhunshëm i cili shkon gjithmone në varësi te vlerës se sherbimit dhe lloit te takses që mbledh shteti. Është e rendësishme te thuhet se jo gjithmonë ky proces i anasjelltë është material e sidomos nese flasim per sherbimet e kryera nga shteti.

Taksat ndonjeherë dinë te kenë nje vi te hollë te dalluesmerisë me tatime e sidomos kur flasim per lartësinë e tyre. Edhe pse është shteti ai qe e ka monopolin e plotë te vendosjes se tyre , ky i fundit duhet te ketë kujdes qe tarifa mos ta tejkalojë sasinë e shfrytzimit të shërbimeve publike. Ne momentin kur ky vëllim tejkalon shfrytzimin e shërbimeve publike atëherë ky alokim kthehet ne tatim.

Historikisht shikuar taskat kanë rënë në një disfavor pikerisht per shkak të mungesës se elasticitetit të tyre ne raport me tatimet. Kjo luhatje e tyre vjenë si nevojë e rrethanave dhe kohes, dhe kjo i ka bërë tatimet si me efikase andaj shume sherbime në shtete të mëdha si Franca apo Britania e Madhe nje varg obligimesh taksapaguse i vendos në kuader te tatim mbledhjes.

2.4. Principet e taksave

Mbledhja dhe arketimi i taksave ndodh përmes disa principeve ku kryesoret janë :

2.4.1. Përparësija historike - Nëse nisemi nga njohësi i vjetër i qështjes se taksimit publik Adam Smith, ai vendosi disa cilësi te cilat duhet te mirren parasysh te taksimi. E para ishte se subjektet e secilit shtet duhet te japin kontribute proporcionalisht te ardhurave qe marrin nga shteti perkatës. E dyta ishte se taksa qe secili individ duhejt ta paguante te ishte e pashmangëshme por jo arbitrare ku gjithsesi duhej ta dijë kohën dhe menyren e mbledhjes se tyre dhe gjithsecili duhej ta kishte te qartë pastertinë dhe qartësinë e tyre. E treta, Taksimi duhej të ishte i percaktuar ne kohë dhe menyre te atillë qe te jetë i përshtatshëm per kontribuesin dhe e katërta pikë sipas Smith ishte ndarja apo largimi i ketyre te hyrave nga

duart e njerëzve sa më shpejt që të jetë e mundur dhe vendosja e tyre në thesarin publik të shtetit.

2.4.2. Paanësija - Si princip i tillë shprehë atë që taksat janë dhe duhet të jenë të drejta si njëra nga politikat bazë të taksave. Paanësija mund të jetë vertikale apo edhe horizontale . Paanësija horizontale adreson pyetjet se nëse sistemi i taksimit bënë dallimet arbitrare në mes taksapaguesve në bazë të kriterëve irrelevantë . Në anën tjetër Paanësija vertikale adreson qështrjen se si njëziti më të ardhura të ndryshme duhet të taksohen duke pasur parasysh aftësinë e tyre për të paguar.

2.4.3. Efikasiteti - Taksa është efiçase nëse shtremberimi i tregut nga kjo e fundit është sa më e vogël për arsye se agjentët tjerë ekonomik tentojnë ta limitojnë apo shmangin detyrimin taksues sa më shumë që të jetë e mundur (Kabinga dhe Jorg, 2016, fq. 5- 10).

2.4.4. Neutriteteti - Një funksion tjetër i taksave është edhe rritja e të hyrave dhe në këtë parim neutraliteti i taksave kontribon në efiçencë duke siguruar në një alokim optimal nga prodhimi i përgjithshëm . Shtuar kësaj neutraliteti garanton se hyrja do jetë sa më e madhe për atë gjatë sa minimizohet diskriminimi pro apo kunder një zgjedhje të caktuar ekonomike.

2.4.5. Parashikimi dhe Siguri - Subjektet biznesore preferojnë të planifikojnë shpenzimet shumë më herët para alokimit të taksave, dhe kjo formë e parashikimit të taksave dhe mbledhjes së tyre e bënë berjen e biznesit shumë më të lehtë. Parashikimi i sistemit të taksimit është një formë joshëse e investimeve në ekonomi. Edhe pse taksat janë një sistem që vazhdimisht ndryshon për shkak të modifikimeve në ekonominë lokale prapë se prapë ato janë të mundshme për tu parashikuar në kohë nëse bizneset e luajnë këtë rol me kujdes.

2.4.6. Proporcionaliteti dhe progresiviteti - Taksat janë qelsi i barazisë dhe në çdo shoqëri . Megjithatë asnjë shtet në botë nuk është terësisht i lirë apo edhe më të drejta të barabarta. Në këto raste sistemi i taksave shërben që në këto sisteme më pabarazi të theksuar të vendosë një dorë të hekurt të proporcjonalitetit. Pabarazija që mund të shtrihet si shkak i keqperdorimit të fuqisë së shtetit nuk shtrihet vetëm në të hyrat dhe fuqinë ekonomike , por shtrihet edhe në aspektin gjinor, etnik dhe sfera të tjera të jetës sociale ku si sistemi i mirfilltë i alokimit i të

hyrave nga shteti luan rol te jashtëzkonshëm ne avansimin e drejtesisë ne shoqeri. Ne ketë aspekt shteti duhet fillimisht te krijoj te ardhura e me pas te kerkohet alokimi i mjetëve ne një form te caktuar te taksave.

2.4.7. Thjeshtësija - Vlersimi dhe qëllimi i taksave duhet te jetë i kuptuar nga nje qytetarë i thjesht i nje vendi andaj sistemi i tyre duhet të ketë dizajn të thjeshtë. Në momentin kur mënyra e pageses, të kuptuarit si dhe qëllimi është i thjeshtë atëherë edhe perqindja e pagesës dhe alokimit të mjetëve është e madhe , dhe njejtë është e kunderta.

Kjo u ndihmon taksapaguesve qe ta kuptojnë qëllimin qysh ne fillim mirpo si e tillë në fillim kerkon nje formatizim dhe modernizim te administratës perkatëse. Kjo i takon ç´do agjensije përgjegjëse për mbledhjen e taksave që ti siguron obliguesit që taksa asesi nuk guxon të jetë barrë per ta dhe thjeshtë është nje e mirë qe kthehet në sherbim ndaj tyre(Kabinga dhe Jorg, 2016, fq. 5- 10).

2.5. Lartësia e taksave

Nje qëshetje tejet me vlerë ne percaktim te taksave është edhe lartësija e tyre. Zakonisht është nje premisë e zakonshme që e percakton lartësine taksave e ajo bazohet te shpënzimet apo lartësija e shpenzimeve. Sa me te larta shpënzimet aq me te larta taksat dhe nje kohësisht aq me te mëdha shërbimet të cilat kryhen përmes tyre.

Kjo formulë duhet gjithsesi te jetë e tillë për arsye se nese nje taksë do ishte më e madhe se shpënzimet për kryerjen e një shërbimi te caktuar, diferenca në kosto që do krijohej në mes koston se shërbimit dhe koston se te hyrave për po të njejtin shërbim atëherë do ta merrte formen e tatimit për arseje që diferenca ne fjalë nuk perfshinë asnje lloj te shërbimit të drejtpërdrejtë. Ne rastët kur lartësija e taksave është me e vogel se kostoja per atë sherbim atëherë pjesa që mbetet e pambuluar duhet të mbushet nga organet shtetrorë .

Shumë herë per shkaqe të ndryshme shteti vendos te mos i përmbahet parimit të lartpërmendur duke vendosur taksa me të larta ne gjykata për qëllime edukative për të mos

patur gjykime të shumta dhe të panevojshme njekohësisht duke ulur taksat në arsim ashtu që të ndikojnë që të ketë ngritje arsimore me të lartë.

Ekzistojnë faktorë të tjerë që ndikojnë në lartësinë e taksave. E para është dobija që ka kërkuesi i shërbimeve prej organëve shtetërore që i ofrojnë ato si dhe agjensive të tjera të përfshira në shërbim. I dyti aspekt që mund të ndikojnë në lartësinë të taksës është edhe ajo se a është në dobi të obliguesit apo është një dobi e një rrethi më të gjerë shoqërorë. Si faktor tjetër mjaftë me rëndësi është fakti i ndikimit të shtetit në atë se a deshiron të pengohet apo lehtësohet mbledhja e të hyrave.

Këto shërbime gjithësesi duhet të jenë monopol i organëve shtetërore për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe asesi nuk duhet të jenë proces i kryer nga organe apo organizata tjera jashtë duarve të shtetit. I gjithë ky proces që kryhet nga agjensionet përkatëse siq janë institucionet doganore, organet administrative, organet gjyqsore është i kompenzuar enkas dhe nuk ka të bëjë fare me të hyrat e drejtpërdrejta por janë të percaktuara nga aktvendime të tjera ligjore (Komoni, 2008).

2.6. Arkëtimi i taksave

Nëse i shikojmë taksat si formë e të hyrave për mbushjen e arkës së shtetit atëherë do shohim se taksat janë shumë më të vogla në raport me tatimet apo format e tjera të përgjithëshme në mbledhjen e të hyrave të cilat shteti i ka në dispozicion.

Ç'ka quhet arkëtim ?

Nëse nisemi të një definim i pranuar përgjithësisht në botë arkëtimi përmbledhë të gjitha të hyrat nga profitet, kontributet, taksat në të mira materiale dhe shërbime, në listen e pagave, taksat në pronësi dhe tranferë të saj. Kjo mund të konsiderohet si njëra ndër format që e matë kontrollin e shtetit në ekonominë vendore. Matja e kufirit të taksës merret si përqindje e caktuar e GDP së vendit dhe përcakton zhvillimin e vendit (OECD, 2018).

Tarifat e taksave janë normativa ligjore dhe përcaktohen nga institucionet përkatëse, si nga ato të nivelit qendrorë ashtu edhe ato të nivelit lokal. Dokumentet e tilla përcaktojnë llojin e

taksës , lartësinë e saj, menyrën e pagesës, subjektet e përfshira si dhe format e ndeshkimit ne rast të moszbatimit (Komoni,2008).

Dy format kryesorë të arkëtimit të taksave janë të ndara në :

- Direkte

- Indirekte (Komoni, 2008)

Taksa direkte nga vetë emri në fjalë janë taksa të cilat mbledhën me para të gatëshme dhe në menyrë direkte të institucionët përkatëse. Kjo taksë aplikohet drejtpërdrejt të të hyrat individuale, ndaj ndërmarrjeve ose dhe taksa në pasuri apo në sigurimin social.

- Taksa individuale përfshinë të hyrat që secili individ i paguan në bazë të të hyrave që i merr në një vit kalendarik.

- Taksa ndaj ndërmarrjeve i referohet ç'do pagese që ju nënshtrohet taksave në ç'do formë të transaksionit që ndërmarrja e kryen në të gjithë botën.

- Taksa në sigurime shëndetsore që përfshinë një detyrim për pundhënës dhe punëmarresin në kryerjen e këtij obligimi (Business Dictionary, 2018) .

Taksa indirekte janë një të hyra që arkëtohen përmes mbledhjes jo të drejtpërdrejt të të hyrave. Të tilla janë ato në konsum, shpenzim , në privilegje të caktuara, detyrat doganore, taksa në shitje dhe TVSH (Business Dictionary, 2018) .

Këto forma të taksave gjithmonë janë më të preferuara dhe kanë përparësi për shkak që fitimet e shtetit janë më të mëdha dhe njëkohësisht mund të ngriten në menyrë që të rriten edhe të hyrat e shtetit . Zakonisht këto taksa paguhen para marrjes së shërbimit , përpos në rastet e procedurave gjyqësore që paguhen në fund të procedurave . Ky shërbim shpeshherë mund të pasqyrohet ndaraz nga shërbimi i kryer , në këtë rast mund të mirret TVSH-ja që figuron në faturë si proces i ndarë. Përgjithësisht taksat indirekte quhen si të tilla për arsye

se pala e tretë është e perfshirë në pagesën në fjalë. Barazimi më institucionin arkëtues është zakonisht në mes kësaj pale dhe shtetit dhe jo më qytetarin drejtpërdrejtë (Investopedia, 2018).

2.7. Klasifikimi i taksave

Taksat në bazë të kritereve të përgjithëshme mund të klasifikohen në një mori ndarjesh të cilat me pas kanë nëndarjet e veta .

Në përgjithësi taksat ndahen në :

- a) **Të përgjithëshme** - Ku përfshihen taksat të cilat janë të njëjta për të gjitha llojet e shërbimeve , pa marrë parasysh organin përgjegjës për arketimin e tyre.
- b) **Speciale** - Te cilat janë të lidhura me qëllime specifike të institucionëve të caktuara (gjykatat, shkollat, institucionet parashkollore, etc.)
- c) **Të përhershme** - Përfshinë grupin e caktuar të të hyrave të cilat janë bazë e përhershme e arketimit shtetrorë dhe i paraprinë çdo krijimi institucional.
- d) **Të ndryshueshme** - Paraqesin grupin e taksave ku mbledhja e tyre është dhe formësohet nga puna e kryer, ku më pas përcaktohet taksa relevante për shërbimin në fjalë (Komoni, 2008).

Një klasifikim tjetër është ai i cili përcakton organët apo nivelet përgjegjëse në mbledhjen e taksave. Këtu kemi dy grupime kryesore:

- a) **Taksat të cilat caktohen nga niveli qendror** (këtu hynë taksat federative apo ato shtetrorë)
- b) **Taksat të cilat ngarkohen nga nivelet tjera të decentralizuara siq janë taksat komunale , ato lokale, etj.**

Shembull i ketij dallimi mund të merret sistemi federativ i SHBA-së, ku këto dy nivele janë të ndara fillimisht në dy grupe e para është taksa federative e cila përfshinë të hyrat që i mbledhë shteti për nevojat të qeverisjes federale, dhe grupi i dytë i taksave i takon shteteve në veçanti ku secili shtet i mbledhë të hyrat për nevojat individuale të tyre (US Tax Center, 2018).

Në bazë të organeve të cilat i kryejnë shërbimet e caktuara e për të cilat qytetari taksohet për shërbimin e marrë, kemi këto lloje të taksave:

a) **Taksat administrative** që më një emer tjetër nihen edhe taksat shtetërore dhe kryhen si pagesa për të gjitha shërbimet të cilat i kryen shteti ndaj subjekteve të caktuara. Ky tip i taksave ka këto ndarje :

1. **Taksa doganore** e cila është një taksë që i'u bëhet e detyruar të gjithë personave juridik dhe individual që merren me qarkullim të mallrave ndërmjet kufinjëve ndërkombëtar (U.S. Customs Border Protection, 2018) .

2. **Taksat konsulare.**

3. **Taksat për qarkullimin e mjeteve motrike.**

4. **Taksat për mbrojtjen e patentave si dhe taksat kadastrale.**

b) Lloji i dytë i taksave janë **taksat gjyqësore** të cilat janë efektive për ç'do proces gjyqësorë dhe procedurat e tij , gjyqëve ekonomike, procedurave juridike, etj.

c) **Taksat nëpunësish** , të cilat u janë paguar nëpunësve të caktuar për shërbimin e kryer , ku të cilat gjejnë aplikim në raste më të rralla.

Sipas kohës se pagesës taksat ndahen në taksa të cilat paguhen në kohën kur kryhet shërbimi të cilat janë tarifa që përmbledhen në pagesën e kryerjes se atë shërbimi si dhe lloji i dytë i taksave është ai i pagesës se mevonshme e cila zakonisht kryhet pas kryerjes se shërbimit.

Një ndarje tjetër e taksave është ajo sipas numrit të kryerjes se shërbimeve:

a) **Taksa individuale** - E cila shërben për të gjitha shërbimet të cilat kryhen mirpo implementimi i saj është veq e veq per secilin shërbimë të kryer shtetrorë.

b) **Taksat paushalle** të cilat shërbejnë për të gjitha shërbimet e kryera nga organet shtetrorë.

Taksat sipas qëllimit të shpenzimit të mjeteve të mbledhura ndahën në dy grupe kryesore :

a) **Taksat të cilat shërbejnë për shpenzim në nevojë të përgjithshme** ku zakonisht në këtë lloj të taksave nuk është i caktuar destinacioni i shpënzimeve nga alokimi i tyre.

b) **Taksat e destinuar** të cilat kanë qëllim dhe destinim në arsyjen e mbledhjes së tyre

Një dallim tjetër i madh është ai në mes taksave shtetrorë dhe atyre komunale

Taksat shtetrorë i kanë edhe dallimet e veta ku këtu kemi 5 nëndarje :

- **Taksat administrative** të cilat janë detyrime të cilat aplikohen nga njesit lokale-komunale për shërbimet e kryera (shkresat, vendimet, dokumentet dhe punët e tjera administrative) . Komunat në këtë rast e kanë edhe monopolin e vendosjes së tarifës gjithmonë kohazi ligjeve në fuqi. Këto taksa zakonisht i përmbahën sistemit të parapagimit në momentin e shërbimit.

- **Taksat gjyqësore** përfshinë të gjitha detyrimet në të gjitha proceset gjyqësore dhe llojet e tyre (gjyqësore, ekonomike , ushtarake, të ekzekutimit, të padive private, për mosmarrveshje, administrative, etj.) . Edhe ky model i taksave i takon llojeve të gjyqëve dhe proceseve në fjalë për tarifën që aplikohen.

- **Taksat konsulare** janë taksa që aplikohen për qëllime diplomatike dhe si të tilla aplikohen nga organet konsulare dhe diplomatike në dobi të atyre personave që kanë nevojë për shërbime të caktuara. Me specifikja e këtyre taksave është se arketohen me valuta të huaja përkatësisht me ato të vendit ku vepron konsolata në fjalë (Komoni, 2008).

- **Taksat komunale** janë taksa të nivelit lokal ku bëjnë pjesë Taksat në palujtshmeri, leje për afarizëm, leje për automjete motorike , etj. Edhe këto taksa kanë tarifa komunale të vendosura nga ligjet në fuqi (Kuvendi i Kosovës, 2008 fq. 8- 11).

Dhe modeli i fundit i taksave është taksa ne pasuri qe perfshinë taksat në mjete motorike , në vegla te prodhimit, në kafshët e punës, etj. (Komoni, 2008)

2.8. Dallimet mes taksave dhe tatimeve

Në perditshmerinë tonë detyrimet qe subjektet individuale dhe jurudike i kanë obligim shtetit ne shumicën e rasteve nuk bejnë ndonjë dallim të caktuar mes tatimeve dhe taksave duke i konsideruara te nenintegruara. E kjo sidomos kur kemi parasysh rolin e medias , shoqerisë civile e shum herë edhe organeve shtetore të cilët nuk i bejnë dallimet ne fjalë. Ne fakt ekzistojnë dallime substanciale mes ketyre dy formave te alokimit.

Ajo se ç'farë e benë dallimin e taksave me tatime mund të thuhet per mes ketij krahasimi :

- Taksa është një pagesë që individi i bën shtetit në këmbim për një shërbim të caktuar.
- Në këmbim të taksës së paguar, individi do duhej të kishte përfitime individuale.
- Taksat mund të mos paguhen në baza të rregullta kohore pasi që ato paguhen vetëm kur e marrim shërbimin e caktuar.
- Taksa është realizim i veçantë i të hyrave .
- Taksa e dedikuar është taksë e hipotekuar dhe përdoret vetëm për një qëllim të caktuar.
- Taksa e dedikuar investohet për qëllimin që është mbledhur.

Ne anën tjetër tatimet përfshinë :

- Tatimi është një shumë e caktuar që secili qytetar i paguan shtetit për pasurinë dhe të ardhurat që ka.
- Në këmbim të tatimeve të paguara, përfitimet janë kolektive.
- Tatimet janë të përhershme dhe si të tilla paguhen rregullisht.

- Tatimi është e hyrë e rregullt shtetërore.
- Tatimet janë të distribuueshme.
- Tatimi i mbledhur rialokohet nëpër sektorë të ndryshëm.

Dallimet e tilla mëtojnë të jenë të veshtira sidomos në sistemet e reja të qeverisjes apo edhe demokracive të reja siq është Kosova. Shpesh herë dëshira që tatimet të ndrojnë për shkak të marrveshjeve kontraktuale të Kosovës me institucione siq është BE , mund të ndikojnë që qasja e qytetarëve mos ta vrej dallimin efektiv mes taksës dhe tatimit (INDEP, 2016).

2.9. Sistemi i Taksave në BE

Bashkimi Evropian nuk ka rol apo ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin e taksave. Sasisa apo lloji i taksë që çdo qytetarë i paguan në Bashkimin Evropian është i caktuar nga qeveritë përkatëse të secilit shtet.

Roli i Bashkimit Evropian në këtë proces është që të mbikqyrë rregullat e taksave kombëtare , për ta parë nëse janë konsistente me me politika të caktuara të Bashkimit Evropian siq janë:

- Promovimi i zhvillimit ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës
- Sigurimi i i qarkullimit të lirë të mallërave, shërbimeve dhe kapitalit në Bashkimin Evropian
- Duke siguruar që bizneset në një vend nuk përparësi të padrejtë të konkurrencës në raport me bizneset e tjera.
- Siguron që taksat nuk diskriminojnë konsumatorët, puntorët apo bizneset nga vëndet e tjera të Bashkimit Evropian.

Këto rregulla kërkojnë në marrveshje unanime nga të gjitha qeveritë antarë të BE-së duke siguruar që të gjitha interesta e secilit shtet antarë janë marrë në konsideratë (EU,2018).

2.9.1. TVSH dhe Akciza

Për ida taksa siq është TVSH dhe taksat në derivate, duhan dhe alkool (Akcizë), te gjitha 28 qeveritë nacionale janë dakorduar që të kenë rregulla gjerësisht të lidhura mës vete dhe norma minimale në mënyrë që të shmangët një lloj shtremberimi i tregut përbrënda kufinjëve të Bashkimit Evropian.

2.9.2. Taksa në ndërmarrje dhe taksa në të hyra

Në takasa të tilla roli i drejtpërdrejtë i Bashkimit Evropian është që të siguroi që qarkullim i lirë i mallrave dhe mos-diskriminimi apo barazija janë principe të patjetërsueshmë. Një politikë e përbashkët është e nevojshme në këtë aspekt në menyrë që të shmangën politikat e gabuara siq është evazioni i taksave.

2.9.3. Të ardhurat e Taksave

Në bazë të legjislacinit në fuqi BE nuk ka fjalë dhe rol në mënyrën së si shpenzohen të ardhurat nga taksat nga shtetet antare. Sidoqoft më rritjen e ndërvarësisë ekonomike ne BE shtetet që shpenzojnë se tepermi dhe hynë në borgje të mëdha , vëjnë në rrezik rritjen ekonomike të fqinjëve të tyre dhe eurozonë në përgjithësi.

Për ta minimizuar këtë rrezik shtetet antare tentojnë që ti bashkërendojnë poltikat e tyre ekonomike, pjesërisht të bazuara nga rekomandimet e organit të Komisionit Evropian.

2.9.4. Taksa në një treg të përbashkët

Taksat individuale dhe të ndërmarrjeve janë përgjegjësi e shtetëve antarë siq u tha edhe me lartë. Sidoqoftë në bazë të rregeullave të Bashkimit Evropian këto shtete nuk duhet të krijojnë pengesa ne rastin e levizjës brenda BE-së. Në rast të këtyre pengesa individët që lëvizin nga një shtet në tjetrin apo edhe kompanitë që zhvillojnë politika tregtare dhe ekonomikë përtej kufinjëve të shtetit amë, mundë të përballën me taksa të dy apo trefishta apo edhe të kenë probleme administrative të komplikuar.

Më këtë qëllim që të largohën këto barriera , ekzistojnë traktate mes shumicës së shtetëve në mënyrë që ta largojnë taksimin e dyfisht edhe pse mund të ketë probleme të aplikimit të saj në praktikë. Komisioni mundohët të munojnë në mënyra të ndryshme që ta eliminojë këtë problem. Kjo zakonisht ndodhë në formën e propozimeve për zgjedhje të koordinuara dhe ne raste më të rënda merr masa ligjore nëse thehen ligjet e BE-së apo shfaqet ndonjë formë e diskriminimit.

2.9.5. Standartizimi i taksave në të mira dhe shërbime

Tregu i përbashkët lejon që të mirat materiale dhe shërbimet të kryhen lirshëm brenda kufinjëve të BE-së. Në mënyrë që kjo të ndodhë shtetët antare të Bashkmit Evropian i kanë bashkërenditur një mori rregullash për taksimin e të mirave dhe shërbimeve.

Një taksë minimale është në fuqi për TVSH de akcizë, s`bashku edhe me rregullat së si duhet të aplikohet kjo taksë. Kështu shtetët antare janë të lejuar të aplikojnë këto modele të taksave minimale gjithmonë duke ndjekur rregullat e paracaktuara të institucionëve të BE-së(EU Taxation,2018).

2.9.6. Evazioni i taksave dhe shmangia e tyre

Ligi mbi taksat në një vend nuk duhet në asnjë menyrë të lejoj shmangjen e tyre në një vend tjetër. Duke marrë këtë që kalimi nga një shtetë në shtetë tjetër dmt. kalimi i kufinjëve në bërjen biznes mund ta shfaq evazionin e taksave dhe një veprim i gjerë nga institucionet e BE-së është i nevojshëm.

Disa rregulla të reja të vëndosura ne fuqi nga organët perkatëse siq është shkëmbimi i informacionit kanë ndikuar në kontroll për mashtrim ne TVSH. EU gjithashtu luan rol të rëndësishëm ne taksimin e drejtë ndaj korporatave. Zbrastirat ligjore mes shtetëve të ndryshme të BE-së , lejon kompanitë që të kenë politikata më të vrazhda që të minimizojnë faturat e taksave të detyrueshme, kështu që BE detyrohet që ta rris ndikimin që politikat e taksave të jenë të hapura dhe të drejta në mënyrë që të shmangën tëndencat e tilla.

2.9.7. Taksa e transaksionëve financiare

Janë 11 shtete antare të Bashkimit Evropian që momentalisht janë duke zhvilluar një sistem për taksimin e transaksionëve financiare, në mënyrë që të siguroj që sektori financiarë të ketë kontribut të drejtë në kostot e recesionit e cila ishte shkaku kryesorë për nevojën e kësaj takse.

Planet janë të dizajnuara që të gjenerojnë të hyra të rendësishme , përkundër një lëvizje të lart ndërkombëtare të transaksioneve financiare.

2.10. Strategjia e politikave të taksimit në BE

2.10.1. Parimet bazë

Si parimë i parë i politikavë të vëndosjë së taksavë brënda kufirit të Bashkimit Evropian është pikërisht liria e tyre dhe percaktimi i tyre nga shtetët antare pa pasur nevojë në një harmonizim (gjithmonë nëse parimet e subsidiarititetit dhe proporcionalitetit është në fuqi dhe nuk thyhet). Be luan rol lehtësues në shumicën e rasteve të tilla ku ka probleme për zgjidhje efektive.

Si parim i dytë është eliminimi i pengesave në bërjën biznes mës shtetëve të BE-së si ato individuale po ashtu edhe korporatave. Kjo nddhë përmes një lufte ndaj informalitetit dhe taksapagimit të dëmshëm të padrejtë.

2.10.2. Largimi i pengesave për qytetarët

Me 20 Dhjetor 2010, në bazë të një strategjie paraprake të quajtur Europe 2020 , Komisioni Evropian filloi më një plan të inkurajimit të individëve që të mos dekurajohën nga rregullat e taksave nga tregu i brendëshem i BE-së. Përmesë këtyre politikave Komisioni Evropian adreson problemet kyqe siq janë: diskriminimi, taksimi i dyfisht, veshtirsitë në mbledhjen e taksave si dhe shperndarja e informacioneve të nevojshme për rregullat e huaja të taksave.

2.10.3. Veprime të tjera në në politikën e takasve

Krahas veprimeve të lartëcekura ekzistojnë edhe disa veprime të koordinuara në trajtim të pengesave në taksa dhe mungesë të efiqjencës. Këto politika janë të dukshme në: Taksat në Ndërmarrje, TVSH, akciza si dhe taksat në fushën e automjetëve. Masa tjera janë ndërmarrë në shmanjje e evazionit në direktivat e kursimeve nga taksat duke ofruar një ndërveprim në administrim të taksave por edhe mbetet punë e madhe në një mori veprimesh siq janë fusha për Kërkim dhe Zhvillim, ndryshimi i sistemit të votimit nga unanime në shumicë të kualifikuar (për fushën e taskave), ndryshime në qasje ku nga një formë detyruese të kalohët në një formë jo obliguese, perditësimin statistikor i të dhënave nga sfera ekonomike më qëllim të analizë së ketyre të dhënave nga shtetet anëtare. Krahas këtyre është edhe promovimi i një qëverisje të mirë në menaxhim të taksave siq është transparenca si dhe shkembimi i informacionit dhe konkurenca e drejtë (Europa, 2018) .

2.11. Taksat dhe Tatimet në Kosovë

2.11.1. Korniza ligjore e organizimit të politikës fiskale në Kosovë

Në Kosovë, kemi një sërë taksash dhe tatimesh të cilat janë të përcaktuara me kornizën përkatëse ligjore apo me udhëzime të ndryshme administrative. Përderisa llojet e tatimeve mund t'i evidentojmë shumë lehtë, llojet e taksave të aplikueshme është më e vështirë të listohen, për shkak se përveç disa prej tyre që janë të përcaktuara nga niveli qendror institucional, shumë të tjera aplikohen në nivel lokal apo në korniza të institucioneve që ofrojnë shërbime të caktuara. Për momentin në Kosovë, aplikohen këto lloje të tatimeve:

- **Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)** – Norma standarde e tatimit është 18% dhe aplikohet në të gjitha mallrat dhe shërbimet me përjashtim të mallrave dhe shërbimeve të listuara në Nenin 26.2 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH me ç ‘rast aplikohet norma prej 8%.

- **Tatimi mbi të ardhurat personale** - Ky lloj tatimi aplikohet në të ardhura nga paga, biznesi, qiraja, interesi, pasuria e patundshme, etj. Normat tatimore të tatimit në të ardhura personale nga paga zbatohen në mënyrë progresive në raport me lartësinë e pagës së fituar . Normat tatimore janë: deri në 960 euro/vit - 0% ; mbi 960 dhe 3000 euro/vit - 4% ; mes të 3001 dhe 5400 euro/vit - 8% ; dhe mbi 5400 euro/vit - 10%.

- **Tatimi në të ardhurat e korporatave** - Norma e tatimit është 10% për të gjitha korporatat me qarkullim vjetorë mbi 50,000 EUR, dhe tatimi paguhet në baza tre mujore (varësisht nga qarkullimi vjetorë).

- **Tatimi i paragjykuar** - Të gjitha bizneset individuale me qarkullim vjetorë më të ultë se 100,000 EUR paguajnë këtë lloj të tatimit.

- **Tatimit në fitim** - Për personat rezident paraqet fitimin e tatueshëm nga të ardhurat nga burimi i Kosovës dhe nga të ardhurat nga burimi i jashtëm dhe aplikohet në normën prej 20% të fitim të tatueshëm. Përderisa për personat jo rezident aplikohet vetëm në fitimin e tatueshëm nga të ardhurat nga burimi i Kosovës.

- **Tatimi në pronë** - Tatimi në pronë paguhet në baza vjetore dhe paraqet një taksë komunale. Vlera e tatimit përcaktohet duke shumëzuar vlerën tatimore të vlerës me vlerën e tatimit të aplikueshëm.

Në anën tjetër, është më e vështirë të klasifikohen edhe taksat në mënyrë strikte si tatimet, pasi që taksa mund të konsiderohen edhe tarifat e ndryshme të përcaktuara nga institucione individuale për dhënie të shërbimeve të ndryshme. Në kuadër të këtij punimi, si taksa të dedikuara shtjellohen taksa rrugore dhe ekologjike e automjeteve si dhe tarifa e sigurimit e Autoritetit të Aviacionit Civil . Mirëpo, duhet qartësuar edhe faktin që me legjislacionin përkatës për buxhet, për momentin janë të definuara vetëm të ardhurat e dedikuara, përderisa

kjo nuk vlen edhe për taksat e dedikuara, edhe pse ato po aplikohen në praktikë (INDEP, 2016).

2.11.2. Funkzioni dhe roli i ATK si agjencion përgjegjës për alokimin e të hyrave

Institucioni i ATK (Administrata Tatimore e Kosovës) është organi përgjegjës për mbledhjen e të hyrave e cila funksion në kuadër të Ministrisë së Financave. Si i tillë ky organ ekzekutiv, u krijua fillimisht në vitin 2000 nën administratë të UNMIK dhe funksion deri me sot si organi përgjegjës për verifikim dhe alokim të parasë publike (krahas Doganës) . ATK ka një kohezion ligjorë të pranuar edhe nga organizmat ndërkombëtarë të fushës siq janë FMN dhe Komisioni Evropian për legjislacion dhe funksion si organ autonom e cila mbanë një raport në formë të këshillimit me organizata ndërkombëtare siq janë BE, USAID, etj.

ATK që nga pavarësimi i vendit ka krijuar marrveshje ndërkombëtare më 14 shtete të Evropës dhe një marrveshje të veçantë me SHBA e cila njihet si FATCA (Foreign Account Tax Compliance Act) . Këto marrveshje janë efektive që nga pavarësimi i vendit e këndej (ATK, 2018) .

Agjencion Tatimorë i Kosovës për dallim nga periudha para pavarësimit të vendit që bazën ligjore e kishte të nxjerrur nga Rregulloret e asaj kohë, tanimë Parlamenti i vendit ka nxjerrur disanga ligjet bazë më të cilat funksionalizohët veprimtarija e ATK-së në teren. Që nga viti 2006 deri me tani ka 27 ligje dhe Plotsim ligje që i atribuohën funksionimit të politikës fiskale përkatësisht ATK-së si organ ku njëri nga ta është edhe ai nr.2004/48 që përkatësisht e institucionalizon ATK-në si agjencion ekzekutiv nën ombrellen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së asaj kohe (Ligji nr.2004/48, 2005).

ATK është përgjegjëse për inkasimin e tatimeve qëndrore qeveritare ku bëjnë pjesë :

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)
- Tatimi në të Ardhurat Përsonale
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

- Tatimet e mbajtura në burim
- Kontributet Pensionale
- Dhënjën e licencave për lojrat e fatit

Tabela 1. Llojet e tatimeve në Kosovë

LLOJI I TATIMIT	PRAGU I QARKULLIMIT	NORMA TATIMORE
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSH	30,000 euro	8% dhe 18 %
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Nën 50,000 euro	
Veprimtaria Prodhuese Tregtare dhe transportuese, etj.		3%
Veprimtaria Shërbyese		9%
Tatimi në të Ardhurat Personale – TAP	Nën 50,000 euro	
Veprimtaria Prodhuese Tregtare dhe transportuese, etj.		3%
Veprimtaria Shërbyese		5%
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Mbi 50,000 euro	10%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP		
Te ardhurat vjetore nga 0 deri 960		0%
Te ardhurat vjetore nga 960 deri 3000		4%
Te ardhurat vjetore nga 3000 deri 5,400		8%
Te ardhurat vjetore 5,400 e tutje		10%
Tatimi në paga (mujor)		
Të ardhurat mujore nga 0 - 80		0%
Të ardhurat mujore nga 80 – 250		4%
Të ardhurat mujore nga 250 - 450		8%
Të ardhurat mujore nga 450 e tutje		10 %
Tatimi në Qira, Interes dhe të Drejta Pronësore		10%
Tatimi në kategorimi të veçanta		3%
Tatimi për jo-rezidentët		5 %

Burimi: (ATK, 2018)

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Gjatë mbledhjes se të dhënave është e parë së në Kosovë vazhdon të jetë një problematikë në ndarjen mes Taksave dhe Tatimeve dhe së sistemi i akumulimit të të hyrave publike është një proces i cili për momentin është pothuajse një drejtimësh (ku tatimet mbesin forma kryesore e akumulimit të të hyrave publike).

Gjatë studimit u pa se sidomos për sistemin e Taksave në Kosovë edhe në aspektin e mbledhjes se të dhënave nga literatura vazhdonë të jetë e mangët duke ditur se si proces është një koncept që evoluon dhe të dhënat rifreskohën. Shumica e të dhënave si burim kishin webfaqet, dokumentat në form të PDF mirpo gjithmonë duke ju referuar vetëm burimeve zyrtare dhe atyre valide ë përkojnë më kohën dhe momentin.

Krahas kësaj duke ditur për rëndësisë e të kuptuarit të asaj së çfarë janë të hyrat publike ky punim kishte edhe për qëllim ta ketë një përmbajtje të asaj së si lidhja input dhe output e të akumulimit dhe distribuimit të të hyrave duhet të jetë, në projekte afatshkurtra, afat mesme dhe afat gjata duke ditur problematikë që ka Kosova në ketë qështje. Kjo problematikë lidhet kryesisht më mos derdhjen e të hyrave nga kauza e parë e mbledhjes së ku në shumicën e rasteve destinimi i tyre ndyshon. Nga kjo arrijmë në përfundim se vetëm më identifikim dhe informimin e duhur të taksapaguesit Kosovarë në mënyrë të drejtë precize dhe gjithashtu të matëshme nga gjithsesili mund të kemi një sistem të mirfilltë të akumulimit dhe derdhjes së paras publike si një zinxhirë i pandashëm.

4. METODOLOGJIA

Studimi ne këtë punim është një hulumtim empirik i mbledhjes së të dhënave ku të dhënat janë të shprehura si në formë të të dhënave kuantitative ashtu edhe ato kualitative të studimit.

Ne aspektin akumulimit të hyrajt janë të dhëna të matshme të shprehura në formë në formë detajuese të shtrira në hapësirë dhe kohë (vende të ndryshme duke përfshirë Kosovën si dhe periudha të ndryshme kohore) .

Punimi nuk përfshinë anketa dhe intervista për arsye se është analizim i efekteve të përgjithshme të taksave dhe si e tillë është e orientuar kryesisht mbi fakte dhe argumente të shkruara dhe të matshme të nxjerrura nga studime relevante në raport me temën.

Një formë e deduksionit të të dhënave është bërë me qëllim që të thjeshtohet të kuptuarit duke ditur se të dhënat e mbledhura janë të shumëllojshme dhe të shtrira në shumë nivele ishte e rëndësishme që këto të dhëna të reduktohen që të jenë të kalkulueshme dhe të matshme. Të dhënat janë empirike dhe dy metodat si kuantitative ashtu edhe ajo kualitative janë shfrytëzuar në mbledhjen e të dhënave.

Mëtoja kuantitative është shfrytëzuar kryesisht në mbledhjen e të dhënave statistikore sidomos të analizimit të mënyrës së mbledhjes së të dhënave të sistemit të taksave në BE dhe në Kosovë.

Mëtoja kualitative u përdor në analizim të të dhënave kryesisht në rastin e raportit të taksave më të fundit , raporti mes taksave të BE-së në nivel qendror dhe shtetëve antare si dhe analizimi kronologjik i zhvillimit të taksës si koncept.

Në përgjithësi tema ka pas si synim të shtjellojë rëndësinë dhe efektin e taksës si koncept dhe rëndësia e saj në zhvillimin ekonomik të vendit andaj në këtë aspekt hulumtimi ju nënshtrua tri standarteve hulumtuese :

a) Qasja historike përmes së cilën ju qasem evoluimit të taksës si koncept që nga Greqija e Roma Antike.

- b) Qasja normative e cila përfshinë të dhënat statistikore të analizuara më lartë përmesë dy metodave, asaj kuantitative dhe kualitative.
- c) Qasja eksperimentale e cila si metodë u përdorë më qëllim të analizimit të ligjeve dhe akteve në fuqi që janë përcaktuese për fuqizimin e taksës si formë e të hyrave shtetërore.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZIMI I REZULTATEVE

Në këtë kapitull do të tentojmë që të i diskutojmë të dalurat kryesore nga analiza e të dhënave së si shihen taksat dhe shpjegimi i tyre dhe roli i tyre në nivel ndërkombëtarë e sidomos nga Bashkimi Evropian dhe në anën tjetër të kuptuarit e taksave në Kosovë, rëndësija dhe roli i tyre në akumulimin e të hyrave publike në vend.

Në përgjithësi nga definimi që ju dha taksave u pa që taksat duhet të ju nënshtrohën disa parimeve bazë para se ato të jenë funksionale dhe të matëshme. Nga studimi i bërë si parim bazë ishte parimi ligjshmërisë ku çdo taksë në parim duhet ta ketë ligjshmerinë e sajë, e kjo fillimisht duke u votuar ne parlament dhe duke e përmbushur kriterinë e kushtetueshmerisë së secilit akt që ka të bëjë më to.

Kriter tjetër apo parim tjetër që u nxor nga studimi është parimi vjetorë, ku si parim e obligon legjislativin (parlamentin) si komandues që ta autorizoj ekzekutivin (qeverinë) që në baza vjetore të mbledhë të hyra si në formë të tatimeve ashtu edhe ne formë të taksave. Barazija është gjithashtu parim i cili përfshinë të drejtën për të qënë i barabart në rolin e kontribuesit në përmbushjen e detyrave në mbledhjen e të hyrave dhe si pikë e katërt është nevoja e cila është e drejtë e shtetit që të reagojë në bazë të nevojave të paraqitura.

Nga nëndarjet e dhëna principet e taksave tregojnë që krahas parimve taksat kanë një rëndësi vitale nëse i nënshtrohën principeve të cekura . Duke i parë dallimet të cilat i bejnë taksat të dallohen nga tatimet , duke i shëndrruar taksat si pagesë "vullnetare" të cilat kryhen vetëm në rast të kërkesës për shërbim të caktuar, principet e lartpërmendura janë vitale për një funksionalizim të drejtë të politikave fiskale. Në këtë vijë të analizës principi i neutralitetit dhe paanësija janë qënsorë edhe për sistemin politiko-fiskal të Kosovës.

Gjatë studimit u pa se shumë llojshmërija e taksave dhe specifikat e tyre janë model ku shteti ka fuqi në fuksion të alokimit të mjetëve që çdo shërbim ndaj qytetarit të jetë burim i të hyrave. Si shëmbull i ndarjes që shteti ka krijuar mekanizmin e vetë të alokimit është ajo e mbledhjes së të hyrave në formë direkte dhe indirekte. Në këtë formë shteti është burim i mbledhjes së të hyrave në dy forma të ndryshme në një produkt apo shërbim të vetëm.

Një analizë tjetër ishte edhe ajo e ndarjës mes tatimeve dhe taksave ku qëllimi kryesorë ishte të arrijmë në një përfundim jo vetëm të diferencimit por edhe rolit të tyre në ekonomi. Nga kjo analizë u pa që ashtu si taksat edhe tatimet janë detyrime ligjore që çdo qytetarë i vendit i ka ndaj shtetit. Përderisa tatimet qëllim kishin akumulimin e të hyrave nga shteti në kohë dhe vend të caktuar kjo nuk vlinte edhe për taksën , gjë që na bënë të kuptojm se sidomos në rastin e shtetëve siq është Kosova që kanë ende barriera të ekonomisë së hapur më shtetët e tjera , tatimet të mbesin mbushësi kryesorë i arkës shtetore. Gjatë mbledhjes se të dhënave sidomos shqyrtimit të dokumentacioneve që vinë nga burime online (publikime të OJQ-ve, mediave madje edhe vetë institucionëve) u pa që shpeshherë të ketë një ngatrrësë mesë tatimeve dhe taksave edhe pse siq u pa gjatë analizës dallimi ishte substancial. Gjatë shqyrtimit të literaturës në një studim të INDEP (e cila është cituar me lartë) u pa që edhe vetë qytetarët e Kosovës nuk e dinë jo vetëm një dallim të tillë por edhe dedikimin e tyre , mënyren e alokimit si dhe distribuimin e tyre që shpeshherë e bënë të jetë bazë për keqperdorime nga pushteti.

Krahas të kuptuarit te taksave në përgjithsësi si model u morë për studim BE. Gjatë analizës u pa që Bashkimi Evropian vë në theks të veçantë rëndësinë e taksave dhe nga ky studim doli se roli i taksës (i cili buron nga politikat individuale të shtetëve në ekonomi dhe janë ato që e përcaktojnë llojin dhe modelin e taksës) është i shtrirë në këto qëllime bazë (të cilat u lartëcekën edhe gjatë punimit):

- Promovimi i rritjes ekonomike dhe krijimi i vendëve të punës
- Sigurimi i lëvizjes së lirë të mallërvave , shërbimeve dhe kapitalit
- Konkurenca e drejtë dhe
- Mosdiskriminimi pavarësisht të qenit person privat apo juridik.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga të dhënat e mbledhura, informatat e nxjerrura si dhe të dhënat statistikore të përpunuara , studimi mbi taksat si formë e alokimit të të hyrave shtetërore arrinë në këto konkluzia, të cilat i kam ndarë në tri pika kryesore:

- E para është ajo që taskat kanë fundament të fuqishëm i cili rrjedhë herët te kulturat e vjetra dhe si e tillë është evoluar deri me sot që gjithmonë të jetë në shërbim të arsyes së pse është venë si e tillë. Ndarjet e shumta të taksave na dergojnë në përfundim të asaj që ky detyrim shtetërorë është i predispozuar të jetë i paanshëm , efikas dhe me qëllim të qartë. Krahas kësaj taksat kanë edhe si parim qështjen e cilësisë në shërbim. Të hyrat që shteti grumbullon si shembull nga TVSH në blerje ndikonë në rritjen e cilësisë por njëkohësisht edhe në stabilitetin dhe rregullin, duke i ikur formave të ndryshme të shmangjes së kompanive ndaj përgjegjsive si taksapaguese.

Nga ky këndvështrim taksat mbesin të pandashme nga tatimet në këtë aspekt , ku të dyjat si forma të ushqimit të ekonomisë shtetërore, mbajnë në binarë forma të ndryshme të ekonomisë informale , si evazioni fiskal, shmangja dhe ikja e përgjegjsisë taksa paguese,etj.

Si pikë e dytë e studimit ishte harmonizimi i politikave ekonomike sidomos të qështja e taksapagimit mes shtetëve antare të Bashkmit Evropianë e që është vitale. Edhe pse politika ekonomike e taksave i takonë secilit shtet veq e veq dhe pothuajse bënë pjesë në të drejtën individuale të shtetëve në këtë fushë, prapë se prapë duke parë nivelin e ndërveprimit të shtetëve dhe duke ditur që BE siguron dy nga të drejtat themelore që zhduk kufinjët, e që janë: ajo e qarkullimit të lirë dhe liria e tregut, prapë problemet përtej kufinjëve shtetërorë shfaqen. Dy probleme që kërkojnë zgjidhje në këtë fushë janë taksa e dyfishtë dhe kuptueshmeria e tyre.

Të taksat e dyfishta vazhdojnë të përballen dy kategori kryesore ata që jetojnë dhe punojnë në vënde të ndryshme dhe ata që janë të penzionuar në një vend tjetër nga vendlindja. Nga ky aspekt ajo që është e nevojshme që në vendet e BE-së të rritet informacioni i mjaftueshmë për secilin qytetarë të tyre që në kohë dhe vend të informohen për ndryshimet që mund të

shfaqën në raste kur detyrimet taksapaguese shfaqin ndryshime mes dy shtetëve antare të BE-së.

Te pika e tretë është përmbledhja e asaj së sa është i mirëorganizuar sistemi i taksave në vend duke parë që në bazë të dokumentacionit relevant, ligjeve në fuqi, akteve administrative, mbledhja e të hyrave përmbushë standartet e kërkuara. Por nga të dalurat u pa që në Kosovë mbetën disa sfida. E para është rishperndarja e të hyrave , zvoglimi i ngarkesës fiskale për bizneset në vendsi dhe lënja pasdore e administratës lokale. Krahas këatyre është edhe problemi i evazionit fiskal i cili është problem në vete shpesh herë kërcenon biznesin Kosovar ashtu sikur që kërcënon sistemin e taksapagimit. Barazia, konkurenca e drejtë stimuli mbesin probleme afatgjata në vend. Në këtë thelb Kosova mbetët të punoj shumë në sferën praktike dhe rezultatet e matshme në terren se qfarë efekti kanë në fakt të hyrat që mblidhen nga shteti dhe cili është efekti i tyre afatgjatë.

7. REFERENCAT

- INDEP, Friedrich Ebert Stiftung, Analizë e politikave (Janar ,2016) , Taksa e Dedikuara ne Kosovë -Ç`ka po marrim në këmbim të pagesës ?, PDF
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-049, (2008) Prishtinë , PDF
- Kabinga, M., reviewed by Alt J. and Kiprotich E. (2016), Principles of Taxation, Jesuit Center for Technological Reflection
- Komoni, S. (2008) Financat Publike, Prishtinë
- Lighi nr. 2004/48, Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kuvendi i Kosovës, (2005) ,Prishtinë , PDF

Burime online:

- Administrata Tatimore e Kosovës (2018), i qasëshëm nga : <http://www.atk-ks.org/portfolio/informata-te-pergjithshme-per-tatimet-ne-kosove/>
- Bussiness Dictionary (2018), What is A Direct Tax ?, i qasëshem nga : <http://www.businessdictionary.com/definition/direct-tax.html>
- Faqja e Bashkimit Evropian, Sistemi i Taksave (2018) : https://europa.eu/european-union/topics/taxation_en
- Faqja e Bashkimit Evropian, Strategjija e taksave (2018) https://ec.europa.eu/taxation_customs/general-information-taxation/eu-tax-policy-strategy_en
- Investopedia (2018), What is a Social Security Tax ?, i qasëshem nga : <https://www.investopedia.com/terms/s/social-security-tax.asp>

- US Tax Center (2018), State Income Tax vs. Federal Tax, i qasëshem nga : <https://www.irs.com/articles/state-income-tax-vs-federal-income-tax>
- U.S. Customs and Border Protection (2018), Èhat is a Customs Duty ? , i qasëshem nga : <https://www.cbp.gov/travel/international-visitors/kbyg/customs-duty-info>